



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2025

VENDIM

Nr. 407, datë 15.07.2025

MBI

**MIRATIMIN E “UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT
GJYQËSOR NË SHQIPËRI 2025-2027”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neneve 61 dhe 94, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës për Hartimin e Udhërrëfyesit për Rritjen e Efiçencës në Sistemin Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Udhërrëfyesi për efikasitetin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri 2025-2027”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

UDHËRRËFYESI

PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR

NË SHQIPËRI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Cilësia, pavarësia dhe efikasiteti janë komponentët kryesorë të një “sistemi efektiv të drejtësisë”. Në vetvete, sistemet efektive të drejtësisë janë një parakusht thelbësor për garantimin e shtetit të së drejtës, për mbrojtjen e të drejtave individuale, në veçanti të drejtave sociale si dhe krijimin e një mjedisi miqësor për investimet dhe bizneset. Siç përcaktohet në dokumentin e politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, (në vijim “Agjenda e Reformës së BE-së”),¹ dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHEI 2030), një nga objektivat kryesore të Agjendës së Reformës së BE-së është forcimi i sundimit të ligjit edhe duke rritur efikasitetin gjyqësor: *“Shqipëria synon të konsolidojë pavarësinë gjyqësore dhe llogaridhënien e gjyqtarëve duke rritur transparencën dhe duke përmirësuar efikasitetin gjyqësor në të gjitha nivelet. Për këtë qëllim, miratimi i një udhërrëfyese gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të zvogëluar ngarkesën e çështjeve të prapambetura është një nga detyrat e para që kërkohet për të punuar drejt arritjes së këtyre qëllimeve”*.

Në këtë drejtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli), në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian është angazhuar për të hartuar Udhërrëfyesin për Efikasitetin e Sistemit Gjyqësor për Shqipërinë (në vijim Udhërrëfyese), duke marrë si pikënisje fushat kryesore të identifikuar tashmë si përparësi në Agjendën e Reformës së BE-së.

Ky udhërrëfyes i fokusuar në 8 (tetë) synime kryesore është hartuar përmes një procedure diskutimi konstruktiv me përfaqësues të gjykatave, anëtarë dhe drejtues të administratës së KLGJ-së, si dhe me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare dhe kombëtare të Projektit EU4Justice.

Këto 8 (tetë) synime apo shtylla kryesore janë:

- 1) Zgjidhja në kohë e çështjeve dhe vendimmarrja cilësore;

¹ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Dokument-Politik-Agjenda-Kombetare-e-Reformave-2024-2027.pdf>

- 2) Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në sistemin gjyqësor;
- 3) Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve përmes vendosjes/përdorimit të teknologjive më të përparuara;
- 4) Rritja e kapaciteteve gjyqësore/administrative;
- 5) Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore për të përmbushur standardet evropiane;
- 6) Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në aktivitetet e sistemit gjyqësor;
- 7) Rritja e bashkëpunimit me bashkëpunëtorët kryesorë të gjykatës;
- 8) Rritja e besimit të publikut.

Për secilin synim janë përcaktuar objektiva dhe aktivitete konkrete për t'u kryer për arritjen e këtyre objektivave. Si në çdo udhërrëfyes, për monitorimin e përputhshmërisë me objektivat dhe synimet, parashikohen tregues të performancës dhe afatet kohore. Udhërrëfyesi përfshin gjithashtu mekanizma për monitorimin e zbatimit të tij dhe parashikon krijimin e një komisioni të përkohshëm që do të ndjekë hap pas hapi zbatimin e tij.

Lidhur me nevojat buxhetore të nevojshme për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi, Këshilli ka marrë parasysh kufizimet ekzistuese dhe të njohura buxhetore, ndaj, planifikimi i aktiviteteve mbështetet në parashikimet aktuale buxhetore afatshkurtra dhe afatmesme me besimin se, mjetet e duhura buxhetore të nevojshme për zbatimin me përpikmëri të këtij udhërrëfyesi dhe arritjen e rezultateve në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027 do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse në kohë dhe masë të mjaftueshme.

Në hartimin e këtij Udhërrëfyesi, Këshilli ka marrë parasysh edhe faktin se ajo vetë por dhe sistemi gjyqësor përballen me sfida të rëndësishme në zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë dokument. Hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti strategjik nuk është në vetvete një arritje e Këshillit, ai përfaqëson sfidat, ambiciet dhe detyrimet që duhet të përmbushen me qëllim mirëadministrimin e drejtësisë dhe garantimin e një sistemi gjyqësor efikas. Rreziqet në mosarritjen e rezultateve janë të mëdha dhe të qenësishme, pasi Udhërrëfyesi është një dokument ambicioz që kërkon angazhim të madh jo vetëm nga vetë Këshilli, por edhe nga gjykatat, çdo gjyqtar dhe administrata e gjykatave, por edhe nga institucionet e tjera me të cilat është e nevojshme një bashkëpunim i ngushtë si Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Shkolla e Magjistraturës (SHM), Prokuroria e Përgjithshme (PP), Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Ministria e Financave (MF), Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi në tërësi, Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA), Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN), etj. Gjithashtu kërkohet dhe është e domosdoshme edhe mbështetja e shoqërisë civile, dhe veçanërisht e partnerëve ndërkombëtarë duke dhënë mbështetjen e tyre financiare dhe ekspertizën teknike të nevojshme për arritjen e rezultateve në kohë. Këshilli shpreh angazhimin e saj maksimal për të përdorur Udhërrëfyesin për arritjen e ndryshimeve domethënëse në gjykata dhe sistemin gjyqësor shqiptar dhe për të kapërcyer vështirësitë në të cilat ndodhen aktualisht.

I. HYRJE

1. Qëllimi dhe rezultatet kryesore

Pika fillestare për reformat aktuale është se Shqipëria duhet të marrë masa efektive për të krijuar një gjyqësor të pavarur dhe efikas, si një element kyç i sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit është një vlerë themelore në çdo shoqëri demokratike dhe është një nga parimet kryesore për Bashkimin Evropian, si dhe për Këshillin e Evropës (KIE). Një sistem gjyqësor efektiv (i pavarur, me cilësi të lartë dhe efikas) dhe një luftë efektive kundër korrupsionit janë me rëndësi të madhe, ashtu si edhe respektimi i të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë. Roli i gjyqtarëve është thelbësor në mbrojtjen e tij dhe është roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor të promovojë pavarësinë gjyqësore dhe të sigurojë administrimin efikas dhe etik të drejtësisë. Shqipëria është e vetëdijshme për sfidat që e presin në forcimin e institucioneve të saj demokratike dhe zhvillimin e rritjes ekonomike për mirëqenien e qytetarëve të saj.

Qëllimi i Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Sistemit Gjyqësor në Shqipëri është të përmirësojë dhe optimizojë funksionimin e sistemit gjyqësor shqiptar, me qëllim sigurimin e një administrimi më të shpejtë, më efikas dhe më transparent të drejtësisë. Ky Udhërrëfyes është një mjet strategjik që do të ndihmojë Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjykatat dhe institucionet e tjera të identifikojnë sfidat dhe të zbatojnë masa konkrete për të përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e proceseve gjyqësore.

Udhërrëfyesi përqendrohet në përmirësimin e funksionimit dhe performancës së sistemit gjyqësor për të siguruar zgjidhje në kohë dhe të drejta të mosmarrëveshjeve. Ai përfshin një qasje të strukturuar për të rritur efektivitetin, shpejtësinë dhe transparencën e sistemit gjyqësor. Objektivat dhe synimet e tij përqendrohen në përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit dhe rritjen e besimit publik.

Në thelbin e tij, Udhërrëfyesi nuk ka të bëjë vetëm me rregullime afatshkurtra. Një sistem gjyqësor efektiv (i pavarur, me cilësi të lartë dhe efikas) dhe një luftë efektive kundër korrupsionit janë me rëndësi të madhe, ashtu si respektimi i të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë.² Pavarësisht nevojave të menjëhershme të sistemit aktual gjyqësor dhe të drejtësisë, Udhërrëfyesi hedh themelet për përmirësime të qëndrueshme brenda sistemit të drejtësisë, me ndikime thellësisht pozitive si në gjyqësor ashtu edhe në shoqëri në përgjithësi. Përfitimet e miratimit të këtij Udhërrëfyesi janë afatgjata, si për gjyqësorin ashtu edhe për shoqërinë shqiptare, e cila aspirojnë të integrohet në Bashkimin Evropian. Për gjyqësorin, Udhërrëfyesi do të ofrojë rrugën e duhur drejt një sistemi drejtësie më efikas, më të organizuar dhe më të sigurt për të ardhmen. Zbatimi në bashkëpunim me institucionet vendase dhe partnerët ndërkombëtarë do të bëjë të mundur uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, optimizimin e përdorimit të burimeve dhe rritjen e

² Progres Raporti i BE, fq. 18

performancës, duke pasur si qëllim përfundimtar një gjyqësor më efektiv dhe të përgjegjshëm. Për shoqërinë, Udhërrëfyeni do të bëjë të mundur konsolidimin e organizmit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, duke e bërë atë më efikas, duke garantuar që drejtësia të jetë e arritshme dhe të ofrohet në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë - diçka thelbësore për të ruajtur vlerat demokratike dhe sundimin e ligjit. Në planin afatgjatë, reformat gjithëpërfshirëse të parashikuara nga ky Udhërrëfyeni do të rrisin stabilitetin shoqëror, do të inkurajojnë rritjen ekonomike dhe do të kontribuojnë në një shoqëri më të fortë dhe më të drejtë, vlera këto të familjes së madhe evropiane.

Udhërrëfyeni është një dokument strategjik thelbësor, sepse ofron një plan të strukturuar masash për të adresuar sfidat me të cilat përballet aktualisht sistemi gjyqësor, duke maksimizuar potencialin e tij për përmirësime afatgjata. Udhërrëfyeni thekson nevojën për reforma sistematike në fusha të tilla si përpunimi në kohë i çështjeve të reja, zvogëlimi i numrit të çështjeve të prapambetura, përdorimi i teknologjisë, zhvillimi dhe trajnimi i stafit të administratës gjyqësore dhe menaxhimi efektiv i gjykatave.

Praktikat më të mira të rritjes së efikasitetit të gjykatave theksojnë faktin se ky proces nuk është thjesht një përmirësim i natyrës teknike, por një gur themeli për të rritur besimin e qytetarëve dhe për të nxitur dinamika të reja të zhvillimit ekonomik dhe për të siguruar më shumë qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale. Një sistem gjyqësor efikas sjell një tërësi përfitimesh, duke filluar nga drejtësia e dhënë në kohën e duhur, akses më i gjerë, ulje të kostove ligjore, siguri ligjore dhe parashikueshmëri, dhe qëndrueshmëri ekonomike.

Gjatë hartimit të Udhërrëfyesit, si fusha kryesore janë identifikuar sa vijon:

- **Menaxhimi efektiv i çështjeve:** Përmirësimi i mënyrës se si çështjet regjistrohen, gjurmohen, trajtohen me përparësi dhe përpunohen brenda sistemit, për të reduktuar vonesat dhe për të siguruar zgjidhjen në kohë. Me procese të thjeshta, integrim të teknologjisë dhe metoda pune më efikase, çështjet mund të zgjidhen më shpejt, duke reduktuar kohën e pritjes për të gjitha palët e përfshira.
- **Trajnimi dhe Zhvillimi i kapaciteteve:** Gjyqtarët dhe stafi administrativ i gjykatës trajnohen në mënyrë të vazhdueshme mbi çështje të administrimit gjyqësor, me qëllim që të jenë të pajisur me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të marrë vendime të drejta, të informuara dhe në kohë. Një administratë gjyqësore e kualifikuar ndihmon në sigurimin e cilësisë më të lartë në vendimmarrje dhe përpunimin më efikas të çështjeve.
- **Integrimi i teknologjisë të avancuar:** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të integruar të çështjeve, krijimi i dosjes elektronike, zhvillimi i seancave dëgjimore në distancë dhe kërkimi ligjor i avancuar për të rritur efikasitetin dhe aksesin. Proceset e thjeshta administrative dhe mjetet digjitale i lejojnë profesionistët ligjorë të shpenzojnë më pak kohë në proceset rutinë dhe më shumë në çështjet thelbësore, duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.
- **Zgjerimi i aksesit në drejtësi/ digjitalizimi:** Shërbimet e ofruara nga gjykatat dhe procedurat gjyqësore të aksesueshme për të gjithë, pavarësisht nga statusi socio-

ekonomik, vendndodhja gjeografike ose aftësia fizike. Përdorimi i platformave online për paraqitjen e çështjeve ose mundësimin e seancave dëgjimore në distancë ndikon në rritjen e ndjeshme të efikasitetit. Sistemet dhe platformat digjitale të përmirësuara mund të rrisin aksesin për individët, veçanërisht ata në zona të largëta, duke i lejuar ata të kenë akses më lehtë me sistemin e drejtësisë.

- **Transparenca dhe llogaridhënia:** Rritja e besimit të publikut tek gjyqësori duke zbatuar sisteme që mundësojnë monitorim më të mirë të proceseve gjyqësore, vendimmarrjes dhe vlerësimit të performancës. Proceset transparente dhe zgjidhjet në kohë të çështjeve mund të nxisin besim më të madh në sistemin e drejtësisë, pasi qytetarët shohin se çështjet trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në kohën e duhur. Nëpërmjet raportimit më të mirë të progresit të performancës dhe rezultateve të çështjeve, sistemi gjyqësor mund të bëhet më i përgjegjshëm ndaj publikut dhe ndaj standardeve të veta.
- **Reduktimi i çështjeve të prapambetura:** Adresimi i vonesave në zgjidhjen e çështjeve duke përmirësuar planifikimin e tyre në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, 2024–2027. Efikasiteti mund të përmirësohet edhe duke përdorur metoda alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ADR).
- **Përmirësimi i infrastrukturës së gjykatës:** Përmirësimi i objekteve fizike ose sigurimi i pajisjeve më të mira për gjykatat për t'u siguruar që ato janë të përshtatshme dhe në përputhje me standardet e sigurisë së gjykatave, arkivave, si dhe infrastrukturës gjyqësore me salla gjyqi të mjaftueshme në numër për të siguruar transparencën dhe publikimin.
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut:** Rritja e rolit edukues të gjykatave përmes programeve të informimit, fushatave ndërgjegjëse ose nismave për edukimin ligjor me qëllim të kuptuarit nga publiku të proceseve gjyqësore dhe të drejtave ligjore.
- **Rritja e besimit publik:** Duke vendosur synime të qarta dhe duke përmirësuar efikasitetin gjyqësor, Udhërrëfyesi rrit besimin e publikut në sistemin ligjor. Vendimet transparente, në kohë dhe të drejta kontribuojnë në një perceptim të përgjithshëm të një sistemi të drejtë, duke rritur besimin në gjyqësor.

2. Metodologjia

Ky Udhërrëfyes është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të Këshillit dhe trupës gjyqësore, si dhe kontributit me vlerë të dhënë nga Ministria e Drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile, me të cilët është konsultuar ky dokument strategjik.

Me urdhrin nr.31, datë 14.02.2025 të Kryetarit të KLGJ-ja është ngritur grupi i punës për hartimin e Udhërrëfyesit për rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor. Për realizimin e detyrave në mënyrë efektive janë emëruar si anëtarë të grupit të punës: z. Markelian Koça, në cilësinë e Kryetarit të Grupit të Punës; znj. Irena Plaku dhe znj. Emona Muçi Anëtarët e Këshillit; z. Ardian Dvorani Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Apelit, znj. Iliba Bezati, Zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, z. Gert Hoxha, Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë (i cili ka zëvendësuar ish-zëvendëskryetarin Flamur Kapllani), dhe z. Bezart Kaçkini, Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Grupi i Punës është asistuar nga sekretariati teknik, i përbërë nga znj. Anjeza Buzo dhe znj. Rezarta Taushani.

Nën drejtimin e kryetarit të grupit të punës dhe me mbështetjen teknike të projektit EU4Justice, gjatë periudhës shkurt - qershor 2025, Grupi i Punës hartoi Udhërrëfyesin për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri, dokument i cili u miratua nga Mbledhja Plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Grupi i punës u mbështet nga ekspertja ndërkombëtare Lorena Bachmaier Winter dhe ekspertet ligjore vendase të EU4Justice, Olta Lolo dhe Valbona Bala (Pajo).

Në periudhën shkurt-qershor 2025, Grupi i Punës u mbledh dhe shqyrtoi shkaqet kryesore që ndikojnë në efikasitetin e pushtetit gjyqësor, si dhe diskutoi zgjidhjet përkatëse. Grupi i Punës u mbledh 13 herë deri në miratimin e këtij dokumenti strategjik. Udhërrëfyesi, indikatorët e performancës, masat konkrete dhe afatet kohore u konsultuan vazhdimisht edhe në takime periodike me trupën gjyqësore të të gjitha gjykatave, me ekspertë të CEPEJ, dhe me organizata të shoqërisë civile.

Diskutimet intensive dhe konstruktive kanë bërë të mundur identifikimin e qëllimeve kryesore, përshkrimin e objektivave, përcaktimin e veprimeve dhe rënien dakord mbi treguesit e performancës, si një nga elementet më sfidues të këtij Udhërrëfyesi. Një kontribut të çmuar kanë dhënë edhe gjyqtarët, të cilët kanë kontribuar në identifikimin e mangësive aktuale në procedurat gjyqësore dhe në menaxhimin e gjykatave dhe e kanë furnizuar grupin e punës me propozime dhe sugjerime, duke iu përgjigjur një pyetësori që u përgatit nga grupi i punës me mbështetjen e Projektit EU4Justice. Grupi i punës ka analizuar përgjigjet e 19 pyetësorëve të dërguar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, si dhe nga 2 gjykatat e apelit (*shih pjesa II “Analiza e Gjendjes Aktuale”*).

Udhërrëfyesi është i harmonizuar me objektiva strategjike të Këshillit të Evidentuara në planet e saj strategjike 2020-2022 dhe 2022-2024, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, si dhe “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”. Udhërrëfyesi parashikon masa që shtrihen në harkun kohor 2025-2027, periudhë e cila përkon edhe me fazën e tretë të reformave madhore, që synojnë: 1) *eliminimin e backlog-ut*, 2) *rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe* 3) *ofrimin e një drejtësie në nivelin dhe standardet e BE-së*.

Ky Udhërrëfyes është hartuar duke pasur parasysh rekomandimet e Raporteve të Progresit të BE-së, standardet evropiane mbi efikasitetin dhe, në veçanti, rekomandimet e përcaktuara në Udhëzimet e CEPEJ mbi “Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë”;³

³ Plani i Veprimit të CEPEJ 2022 – 2025: “Digjitalizimi për një drejtësi më të mirë”, të miratuar në takimin e 37-të plenar të CEPEJ në Strasburg dhe në internet, më 8 dhe 9 dhjetor 2021, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/cepej-2021-12-en-cepej-action-plan-2022-2025-digitalisation-justice/1680a4cf2c>

“Mjetet për Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura”,⁴ 2023; “Udhëzimet e rishikuara të SATURN për menaxhimin e kohës gjyqësore”⁵, të përditësuara në 2021; Opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) Nr. 6 mbi “Gjykimin e drejtë me një kohë të arsyeshme”;⁶ Opinionin Nr. 11 mbi “Cilësinë e vendimeve gjyqësore”,⁷ Udhëzimet e CEPEJ mbi Afatet Kohore, Opinionin Nr.14 të KKGJE “Drejtësia dhe Teknologjia e Informacionit”,⁸ Opinioni Nr. 24 i CCJE-së, “Evolucioni i Këshillave Gjyqësorë dhe roli i tyre në sistemet gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”,⁹ etj.

II. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Reforma gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë e filluar në vitin 2014, përfshiu një tërësi ndryshimesh kushtetuese dhe hartimin e një sërë ligjesh organike që synonin forcimin e garancive të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe integritetit brenda sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e funksionimit të tij efikas. Reforma gjyqësore e vitit 2016 çoi në një reformim të thellë të kuadrit ligjor dhe institucional të gjyqësorit, e shoqëruar edhe me procesin e rivlerësimit kalimtar të magjistratëve. Këshilli u krijua si një organ kushtetues përgjegjës për ta udhëhequr gjyqësorin drejt standardeve më të larta të efikasitetit, në përputhje me standardet evropiane, kryesisht të përcaktuara në udhëzimet e CEPEJ-it, si dhe në dokumentet e BE-së.

Sistemi gjyqësor ka hyrë në fazën e konsolidimit institucional të gjykatave, si në aspektin e forcimit të kapaciteteve njerëzore ashtu edhe në rritjen e efikasitetit në administrimin e drejtësisë. Reformat strukturore dhe organizative të sistemit gjyqësor kanë sjellë rezultate konkrete, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore dhe në rritjen e besimit të publikut te drejtësia. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar monitorimin dhe analizën e arritjeve, sfidave dhe tendencave kryesore që karakterizuan sistemin gjyqësor në mënyrë periodike, duke marrë në konsideratë veçanërisht ndikimin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura 2024 – 2027. Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore, që ka filluar në vitin 2023, ka qenë një faktor kyç në përmirësimin e treguesve të sistemit gjyqësor.

⁴ Miratuar në takimin e 40-të plenar të CEPEJ (Strasburg, 15-16 qershor 2023), i aksesueshëm në:

<https://rm.coe.int/backlog-reduction-tool-en/1680b2ca1e>

⁵ Udhëzimet e Rishikuara të SATURN për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore (rishikimi i 4-të), të miratuara në takimin e 37-të plenar të CEPEJ (Strasburg dhe në internet, 8 dhe 9 dhjetor 2021), i aksesueshëm në:

<https://rm.coe.int/cepej-2021-13-en-revised-saturn-guidelines-4th-revision/1680a4cf81>

⁶ Opinioni Nr. 6 (2004) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) në vëmendjen e Komitetit të Ministrave mbi gjykimin e drejtë brenda një afati të arsyeshëm dhe rolin e gjyqtarit në gjykime duke marrë parasysh mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, 24 nëntor 2004, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/168074752d>

⁷ Opinioni Nr. 11 (2008) i KKGJE në vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg, 18 dhjetor 2008, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/16807482bf>

⁸ Opinioni Nr. 14 i KKGJE-së “Drejtësia dhe teknologjitë e informacionit (IT)”, Strasburg, 7-9 nëntor 2011, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/168074816b>

⁹ Opinioni Nr. 24 i CCJE-së, “Evolucioni i Këshillave Gjyqësorë dhe roli i tyre në sistemet gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”, Strasbourg, 5 November 2021, accessible at: <https://rm.coe.int/opinion-no-24-2021-of-the-ccje/1680a47604>

Riorganizimi i kompetencave territoriale të gjykatave ka sjellë konsolidimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve të trupave gjyqësore në gjykatat me ngarkesë më të lartë, si dhe shpërndarje më të drejtë të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve. Gjithashtu, miratimi dhe vënia në zbatim e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Backlog-ut 2024–2027 ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin më efektiv të çështjeve të mbartura, përmes masave si: trajtimi me përparësi i çështjeve më të vjetra dhe me ndikim më të lartë në publik, rritjes së rendimentit mesatar për gjyqtar (Treguesi ER), i cili në shumë gjykata është rritur me 10–20% krahasuar me vitin e kaluar, rritjes së numrit të gjyqtarëve efektivë në detyrë. Pavarësisht përmirësimeve të mësipërme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për të rritur efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe për të vijuar me një përgjegjësi edhe më të lartë zbatimin e reformave me qëllim ofrimin e një drejtësie më të shpejtë, më të aksesueshme dhe më të besueshme për qytetarët.

Udhërrëfyeni për Efikasitetin e Sistemit Gjyqësor do të shërbejë për adresimin në kohën e duhur dhe me kapacitetet e duhura të sfidave si: (i) Plotësimi i mëtejshëm i vakancave në trupat gjyqësore, sidomos në gjykatat me ngarkesë të lartë, (ii) Përmirësimi i mëtejshëm i normës së likuidimit të çështjeve dhe kohëzgjatjes së gjykimeve. (iii) Forcimi i kapaciteteve logjistike dhe digjitale për administrimin më efikas të çështjeve gjyqësore dhe për garantimin e aksesit më të gjerë të publikut te drejtësia, (iv) Rritja e cilësisë së vendimmarrjeve, për të përmirësuar më tej standardet e drejtësisë materiale dhe procedurale, duke ulur normat e ankimeve dhe kthimin e çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta. Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vijojë të përmbushë rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian dhe të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë si dhe zbatimin e reformave me qëllim krijimin e një sistemi gjyqësor që gëzon besimin e publikut.

Sfidat që hasin gjykatat në dhënien e drejtësisë dhe që i pengojnë ato të jenë efikase janë të shumëllojshme. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe të posaçëm të shkallës së parë dhe të apelit, përmes plotësimit të pyetësorit kanë evidentuar si të tilla: *staf gjyqësor mbështetës i pamjaftueshëm, numri në rritje i çështjeve të prapambetura, financimi dhe burimet e pamjaftueshme, teknologjia dhe sistemet e vjetëruara të menaxhimit të çështjeve, vonesat në përpunimin e çështjeve, kompleksitetet ligjore dhe procedurale, mungesa infrastrukturore (mungesa e sallave) dhe në burime njerëzore*. Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve efektivisht në detyrë është evidentuar si një nga faktorët kryesorë që ka sjellë si pasojë edhe një numër të lartë të çështjeve për gjyqtar, si dhe një ngarkesë pune të papërballueshme edhe për sekretarët gjyqësorë të cilët janë të ngarkuar edhe me asistimin e seancave gjyqësore. Nga ana tjetër, gjykatat kanë sjellë në vëmendje se financimet dhe burimet e pamjaftueshme krijojnë pengesa dhe mundësi të pakta për të rekrutuar burime njerëzore të mjaftueshme për të përballuar ngarkesën dhe stokun e krijuar. Sistemi elektronik ICMIC me anë të të cilit operon veprimtaria gjyqësore gjeneron të dhëna të pamjaftueshme për të identifikuar regjistrimin e çështjeve që kanë objekt të njëjtë. Mungesa e sallave gjyqësore ndikon në menaxhimin eficient (efektiv dhe të shpejtë) të çështjeve, për arsye se zhvillimi i seancave gjyqësore bëhet i kufizuar, sipas një planifikimi të dakordësuar nga gjyqtarët.

Në lidhje me ndikimin e shpërndarjes së burimeve njerëzore (gjyqtarët, ndihmësit ligjorë, sekretarët gjyqësorë) në efikasitetin e gjykatave, evidentohet se shtimi dhe plotësimi në tërësi i organikës së gjykatës do të sillte shpërndarjen e ngarkesës së çështjeve për gjyqtar. Asistimi i gjyqtarëve me staf mbështetës, ndihmës ligjorë dhe sekretarë gjyqësorë (2 për gjyqtar) do të ndikonte në një ritëm më të shpejtë të procesit të gjykimit.

Në lidhje me ndikimin e ndarjes së buxhetit në efikasitetin e gjykatës, një pjesë e gjykatave vlerësojnë se buxheti është i pamjaftueshëm për krijimin e infrastrukturës së nevojshme, apo për mundësi shtim stafi si, gjyqtar, ndihmës ligjor, sekretarë gjyqësor (2-gjyqtar), apo për intership në gjykatë. Një ndër problematikat që ndeshet më shpesh është çështja e arkivës, pasi kushtet në të cilat mbahen dosjet nuk plotësojnë standardet bashkëkohore mbi integritetin e dokumentacionit.

Në lidhje me ndikimin e burimeve teknologjike (sistemet e menaxhimit të çështjeve, dosja digjitale, teknologjia e sallës së gjyqit) në efikasitetin e gjykatës, konstatohet se parametrat mbi teknologjinë e informacionit, pajisjet elektronike, përfshirë edhe sistemin e menaxhimit të çështjeve, kanë pasur përmirësim të vazhdueshëm. Këto përmirësime kanë ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e punës. Problematikat kanë të bëjnë me mënyra e aplikimit të regjistrimit të të dhënave të çështjes në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve i cili nuk krijon lehtësi në marrjen e të dhënave (copy-paste) për përpilimin e vendimit përfundimtar, ndërsa mungesa e kompjuterëve për gjyqtarët nëpër sallat e gjykimit pamundëson aksesin e tyre në legjislacion elektronikisht. Burimet teknologjike, pavarësisht mangësive të sallave të gjykimit dhe të kushteve materiale të tyre, përdorimi i sistemit audio ka përmirësuar dhe ka sjellë rritje të ndjeshme të efikasitetit dhe produktivitetit të seancave gjyqësore. Regjistrimi audio ka rritur besueshmërinë e palëve se çdo pretendim që do diskutohet gjatë gjykimit do jetë e regjistruar.

Këshilli mbetet e angazhuar për të siguruar një sistem sa më modern të menaxhimit të integruar të çështjeve, të aftë për t'u përshtatur menjëherë me zhvillimet e shpejta teknologjike, digjitalizimin e plotë të proceseve gjyqësore, përfshirë edhe digjitalizimin e dosjeve gjyqësore ekzistuese fizike në të ardhmen e afërt.

Ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë më shumë në vonesat në zgjidhjen e çështjeve në gjykatë, evidentohen praktikat joefikase të njoftimit, mungesa e ndihmësve ligjorë, koordinimi i dobët ndërmjet palëve të interesuara, shtyrje të tepërta të seancave, ngarkesa e papërbalueshme, keqfunksionimi i sistemit të adresave, mangësitë e shërbimeve postare, mangësitë në ligjin procedural për mënyrën e njoftimeve, etj.

Gjykatat evidentojnë një grup subjektsh procedurale që kontribuojnë më shumë në vonesat në zgjidhjen e çështjeve në gjykatë. Vonesat më të shpeshta vijnë nga avokatët mbrojtës, të pasuar nga institucionet publike, prokurorët, dhe më pak nga avokatët e shtetit.

Thjeshtëzimi i procedurave të komunikimit janë sfidat kryesore që ndikojnë në efikasitetin e gjykatës. Për të adresuar këtë problematikë, KLGJ-ja në përmbushje objektivave të këtij Udhërrëfyesi do të vijojë të forcojë marrëdhëniet e bashkëpunimit përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me Drejtoritë e Policisë, Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve, Postën Shqiptare, Zyrën e Gjendjes Civile, ASHK etj., me qëllim).

Gjykatat evidentojnë si mundësi dhe përparësi në sigurimin e efikasitetit: *gjyqtarë/staf i gjykatës i aftë dhe i përkushtuar, menaxhimin efektiv të procesit, përdorimin e mjeteve alternative të njoftimit, komunikimin aktiv me bashkëpunëtorët e gjykatës, përdorimin e teknologjisë, qasjen uniforme të trupës gjyqësore ndaj shtyrjeve.*

KLJG mbetet e angazhuar për të siguruar burime njerëzore dhe financiare të cilat përmbushin nevojën për mbështetje shtesë në personel apo investime në infrastrukturë dhe teknologji në gjykata. Shtimi i numrit të sekretarëve gjyqësorë dhe ndihmësve ligjorë, rritja e kapaciteteve të tyre profesionale përmes trajnimit fillestar dhe vazhdues, shtimi i sallave të gjykimit, i ambienteve për të sistemuar dosjet gjyqësore, përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurisë së gjykatës, mbeten disa nga prioritetet që KLJG synon të përmbushë edhe në kuadër të këtij Udhërrëfyesi.

III. SYNIME DHE OBJEKTIVA

Udhërrëfyesi për efikasitetin e sistemit gjyqësor është strukturuar në 8 (tetë) synime kryesore, me një seksion të fundit mbi monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tij. Brenda “objektivave”, dokumenti përcakton se cilat janë rezultatet e pritshme që duhen arritur nga kryerja e veprimeve konkrete nga strukturat e KLJG-së, gjykatave apo edhe institucioneve të tjera si Ministria e Drejtësisë, KLP, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Avokatëve, etj. Veprimet që duhen kryer përshkruhen në mënyrë sa më të detajuar, afati kohor për kryerjen e veprimeve të tilla është ndarë sipas viteve të fillimit dhe të mbarimit, treguesit e performancës ose të rezultateve janë parashikuar qartësisht, si dhe janë evidentuar strukturat përgjegjëse për kryerjen e veprimeve të përcaktuara. Plani i veprimit përmban edhe koston e nevojshme për zbatimin e Udhërrëfyesit, me qëllim parashikimin në kohë dhe miratimin e burimeve financiare për zbatimin pa pengesa të tij.

Duhet theksuar se ky Udhërrëfyes, edhe pse parashikon Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin përgjegjës për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit, përgjegjësia për përmirësimin e efikasitetit të sistemit të gjyqësor duhet parë si një mision i përbashkët i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë. Një tërësi faktorësh dhe pengesash të efikasitetit të sistemit gjyqësor qëndrojnë jashtë fuqive dhe kompetencave të Këshillit apo gjykatave dhe për këtë arsye në lidhje me një numër veprimesh, roli i Këshillit është i përqendruar në nxitjen e reformave, monitorimin e përparimit, mbledhjen e informacionit statistikor, hartimin e akteve nënligjore dhe koordinimin me institucione që i përkasin degëve të tjera të pushteteve.

Këshilli vlerëson se koordinimi në shumë nivele duhet të jetë e vetmja qasje për të mundësuar rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Shumica e veprimeve të përfshira në Udhërrëfyes janë të ndërvarura, pasi një veprim i vetëm nuk do të shërbente për të arritur objektivat e parashikuara. Për Këshillin ka qenë e pamundur që të përcaktojë një nivel prioriteti mes objektivave apo veprimeve, megjithatë aspekti kohor i përmbushjes së tyre është përcaktues i natyrës prioritare. Në kontekstin aktual të Shqipërisë, objektivi më urgjent është ulja e numrit të çështjeve të prapambetura, dhe për këtë qëllim, plotësimi i vendeve të lira dhe rritja e produktivitetit mund të identifikohen si prioriteti kryesor.

Përmbushja e masave të propozuara bazohet në supozimet se në vitet në vijim 2025 - 2027 do të zbatohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme: (i) rritje graduale deri në plotësimin e numrit të gjyqtarëve në detyrë, (ii) rritje graduale deri në plotësimin e numrit të stafit mbështetës të gjyqtarëve; (iii) rritje të performancës gjyqësore, (vi) përmirësim të metodave të punës në drejtim të efikasitetit, (iv) miratim nga legjislativi brenda vitit 2025 të ndryshimeve ligjore të propozuara, (v) buxheti i miratuar t'í përgjigjet nevojave në rritje të pushtetit gjyqësor për burime njerëzore dhe standarde infrastrukturore. Skenarët optimistë lidhur me ritmin e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura mund të ndikohen pozitivisht dhe në mënyrë të konsiderueshme vetëm nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në gjykata (gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë), e kombinuar me zbatimin kumulativ të masave për uljen e volumit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimin e shpejtë të ndryshimeve ligjore që synojnë të menaxhojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

Synimi 1: Zgjidhja në kohë e çështjeve dhe vendimmarrja cilësore.

Cilësia e drejtësisë në një kuptim të ngushtë, shpesh kuptohet ekskluzivisht si “cilësia e vendimeve gjyqësore”. Në një kuptim më të gjerë, ajo mbulon gjithashtu aspekte kyçe të mënyrës se si ofrohen shërbimet gjyqësore. Në këtë rast, Udhërrëfyesi synon të arrijë cilësinë në kuptimin e gjerë, duke përfshirë aspekte që shkojnë përtej cilësisë së vendimit gjyqësor. Ky koncept përfshin gjithashtu parametra të tillë si afatet kohore, shkallët e zbatimit të aktivitetit, etj. Megjithatë, nën këtë synim ekziston edhe objektivi specifik i përmirësimit të efikasitetit, por edhe cilësisë së vendimeve gjyqësore. Ky synim i parë është përparësia kryesore për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Padyshim që është i lidhur edhe me përmbushjen e synimeve të tjera. Ndërsa ky synim ka për qëllim të adresojë sfidën për një sistem drejtësie efikas si një synim afatgjatë, synimi tjetër (zvogëlimi i numrit të çështjeve të prapambetura) përqendrohet në miratimin e masave urgjente për të adresuar situatën aktuale problematike të vonësve serioze në sistemin gjyqësor.

Sipas objektivave 1.1 dhe 1.2, Udhërrëfyesi parashikon masat për të plotësuar vendet e lira në gjyqësor, si në gjyqtarë ashtu edhe në stafin jo-gjyqtar. Ky është prioriteti kryesor, edhe pse procedura për rekrutimin e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës është tashmë në rrugë të mbarë, përsëri Udhërrëfyesi parashikon veprime për të përshpejtuar këtë

procedurë dhe duke parashikuar përqindje të sakta që duhet të arrihen në afat të shkurtër dhe të mesëm.

Procedura strikte e përzgjedhjes së ndihmësve/ këshilltarëve ligjorë, e kombinuar me një trajnim paraprak dhe të detyrueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe interesi i ulët nga ana profesionistëve të së drejtës për të ndjekur këtë karrierë, rezulton në mungesën strukturore të ndihmësve/këshilltarëve ligjorë. Këshilli, duke marrë parasysh nevojën e çdo gjyqtari për më shumë mbështetje të specializuar nga ndihmësit ligjorë, ka marrë masa për ngritjen e njësisë ligjore edhe në gjykatat e shkallëve të para. Gjithashtu Këshilli, nga maji i vitit 2024 ka paraqitur në Kuvend edhe propozime për ndryshime ligjore në lidhje me mënyrën e rekrutimit të ndihmësve ligjorë, duke e vlerësuar këtë mundësi si një alternativë që mund ta zgjidhë edhe problemin e mbingarkesës së punës që kanë gjyqtarët aktualisht. dhe të çojë në rritjen e numrit të personelit mbështetës në gjykata.

Sipas objektivit 1.3, Udhërrëfyesi planifikon rritjen e efikasitetit gjyqësor përmes zbatimit të standardeve kohore dhe sasiore të miratuara nga Këshilli. Standardet mbi afatet kohore dhe ngarkesën e punës janë thelbësore për një menaxhim efikas të sistemit gjyqësor, si dhe për një planifikim të përshtatshëm të burimeve njerëzore dhe sigurisht për të siguruar aksesin në drejtësi dhe të drejtën për një gjykim të drejtë pa vonesave të panevojshme. Vendosija e afateve kohore është një hap themelor për të filluar matjen dhe krahasimin e performancës së përpunimit të çështjeve dhe për të përcaktuar më mirë konceptualisht “çështjet e prapambetura”.

Përcaktimi i standardeve kohore dhe sasiore buron si një detyrim ligjor nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Standardet ekzistuese mbi afatet kohore dhe ngarkesën e punës për gjyqtarët të vitit 2010 duhet të rishikohen dhe përditësohen për t’u përshtatur me një vizion të ri të sistemit gjyqësor dhe një realitet të ri të zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

Objektivi 1.4: Përdorimi i mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve rekomandohet në dokumentet e politikave dhe standardet ndërkombëtare si një mënyrë për të zvogëluar ngarkesën e çështjeve në gjykata.¹⁰ Në veçanti, në zhvillimin e veprimeve të parashikuara në 1.4, do të ndiqet programi i ndërgjegjësimit të CEPEJ për ndërmjetësimin për gjyqtarët “Sigurimi i efikasitetit të Referimit Gjyqësor në ndërmjetësim”.¹¹

¹⁰ Mjeti i Zhvillimit të Ndërmjetësimin për Sigurimin e Zbatimit të CEPEJ. Udhëzime mbi ndërmjetësimin, të aksesueshme në: <https://rm.coe.int/mediation-development-toolkit-ensuring-implementation-of-the-cepej-gui/16808c3f5>; dhe Rekomandimi (2002) 10 i KiE-së mbi ndërmjetësimin në çështjet civile; Rekomandimi (2001) 9 mbi alternativat ndaj procesit gjyqësor midis autoriteteve administrative dhe palëve private; Rekomandimi (98) 1 mbi ndërmjetësimin familjar; Rekomandimi (99) 19 në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale.

¹¹ Miratuar në mbledhjen e 33-të Plenare të CEPE-së, Strasburg, 5 dhe 6 dhjetor 2019, e aksesueshme në: <https://rm.coe.int/cepej-2019-18-en-meditation-aëareness-programme-for-judges/168099330b>.

Promovimi i zbatimit aktiv të procedurave të ndërmjetësimit, rritja e ndërgjegjësimit midis qytetarëve për procedurat e ndërmjetësimit duhet të nxitet nën këtë titull në bashkëpunim të ngushtë me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Promovimi i alternativave ndaj procesit gjyqësor duhet të arrihet në bazë të këtij objektiv, së pari duke bërë një vlerësim të përdorimit aktual të këtij mekanizmi dhe shkallës së suksesit. KLGJ-ja, si hap i parë, do të kërkojë dhe analizojë të dhënat në lidhje me numrin e rasteve që janë referuar nga gjykatat për ndërmjetësim. Trajnimi do të përfshijë gjithashtu këtë temë, për t'i njohur gjyqtarët se si të nxisin përdorimin e ndërmjetësimit pa shkelur të drejtën e palëve për akses në gjykatë dhe pa shkelur parimin e paanshmërisë.

Objektivi 1.5: Sipas Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGJE), pavarësia gjyqësore duhet të konsiderohet si një e drejtë e qytetarit. Çdo sistem gjyqësor jo vetëm që duhet të garantojë që përdoruesit e gjykatës të kenë të drejtë akses në gjykata, por gjithashtu duhet të sigurojë, nëpërmjet cilësisë së vendimeve të dhëna, që ata të kenë besim në rezultatin e procesit gjyqësor.¹² Cilësia e vendimeve gjyqësore varet nga faktorë të shumtë, siç janë profesionalizmi i gjyqtarëve, cilësia e legjislacionit, motorët e kërimit, stafi mbështetës si ndihmës ligjor, ligji procedural, menaxhimi i çështjeve, seancat dëgjimore produktive dhe elementët specifikë për çështjen në mosmarrëveshje.¹³ Këta elementë merren në konsideratë brenda Udhërrëfyesit, sepse rritja e efikasitetit dhe cilësisë së procesit të vendimmarrjes është thelbësore për besimin në drejtësi.

Sipas objektivit 1.5 parashikohet miratimi i modeleve standarde dhe zbatimi i përdorimit të tyre. Ky objektivi do të zbatohet duke marrë në konsideratë standardet evropiane. Pavarësisht nga qëllimet në aspektin e thjeshtimit dhe qartësisë, pavarësia e gjyqtarëve në vendimmarrjen e tyre duhet të jetë gjithmonë një përparësi kur bëhet fjalë për zhvillimin e modeleve për procedurat dhe vendimet gjyqësore. Sipas këtij objektiv, kërkohet miratimi i modeleve, të cilat janë të përshtatura me modelet e përdorur në gjykata, me qëllim lehtësimin e punës së gjyqtarëve, por pa kufizuar pavarësinë e tyre gjyqësore. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se procesi i përmirësimit të cilësisë së dokumenteve gjyqësore nuk synon të hyjë në themelin e vendimeve¹⁴, duke respektuar kështu edhe qëndrimin e KKGJE-së, se metoda e vlerësimit të cilësisë së vendimeve gjyqësore nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e gjyqësorit as në tërësi dhe as në baza individuale.¹⁵

Objektivi 1.6: Një shpërndarje korrekte dhe proporcionale e ngarkesës së punës, si dhe një menaxhim i shëndoshë dhe efikas i çështjeve janë elementë parësorë për përsheptimin e procedurave, pa ulur cilësinë e shërbimit të drejtësisë. Një sistem menaxhimi çështjesh

¹² Opinioni Nr. 1 të KKGJE-së mbi standardet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve (2001) dhe Opinioni Nr. 11 mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore (2008), paragrafi 4.

¹³ Ibid., parag. 20.

¹⁴ “Lista e kontrollit për promovimin e cilësisë së drejtësisë dhe gjykatave”, e miratuar nga CEPEJ në mbledhjen e saj të 11-të plenare në korrik 2008, paragrafi 21.

¹⁵ Opinioni Nr. 11, parag. 59 të KKGJE.

që shpërndan në mënyrë objektive dhe të barabartë çështjet midis gjyqtarëve në detyrë në një gjykatë është thelbësor për të parandaluar drejtësinë selektive dhe korrupsionin, si dhe për të siguruar efikasitet në shpërndarjen e ngarkesës së punës. Për këtë qëllim, shpërndarja e çështjeve duhet të bëhet rastësisht dhe mundësisht nga një sistem i automatizuar i kompjuterizuar. Një kërkesë paraprake për këtë është miratimi i rregullave të parashikuara në nenin 94 të ligjit “Për organet e qeverisje” (Rregullat e Brendshme të Gjykatave). Udhërrëfyeni përcakton se këto rregulla duhet të jenë të hartuara dhe të miratuara deri në vitin 2026.

Objektivi 1.7: Roli i statistikave të sakta dhe gjithëpërfshirëse është thelbësor në procesin e matjes së performancës së gjykatave dhe për vlerësimin e cilësisë së drejtësisë.¹⁶ Në veçanti, statistikave janë jashtëzakonisht të rëndësishme në procesin e matjes së kohëzgjatjes së procedurave, ngarkesës së punës, si dhe për planifikimin e burimeve njerëzore të nevojshme. Një sistem i përmirësuar i mbledhjes dhe monitorimit të statistikave gjyqësore mat dhe menaxhon performancën në një mënyrë më të detajuar dhe të sofistikuar.¹⁷ Në këtë kontekst, do të kërkohej bashkëpunim i ngushtë ndërmjet institucioneve shqiptare dhe CEPEJ.

Synimi 2: “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura”

Objektivat e përcaktuara nën qëllimin 2 janë përafëruar me objektivat e përcaktuara tashmë në Strategjinë Kombëtare Për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura 2024 -2027. Brenda kontekstit të reduktimit të numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, parashikohet një numër veprimesh, disa prej të cilave kanë filluar tashmë. Ndër të tjera, parashikohet të ripërcaktohet sistemi i trajtimit të çështjeve, duke i dhënë përparësi çështjeve të caktuara. Një masë e tillë është në përputhje edhe me Mjetin e CEPEJ për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, duke bërë të mundur që çdo gjyqtar të analizojë veprimin e fundit të ndërmarrë në secilën çështje të prapambetur dhe të identifikojë hapat e mbetur për zgjidhje efikase të çështjeve. Prioritizimi i çështjeve sipas Strategjisë dhe udhëzimeve të CEPEJ do të bëhet sipas pikës 2.1, si dhe përpunimi i një inventari të llojeve të çështjeve që do të trajtohen si përparësi. Analiza periodike e ngarkesës së punës së gjyqtarëve, për të siguruar shpërndarjen adekuate të çështjeve/punës, do të përfshihet si një aktivitet standard, bazuar në të dhëna statistikore sasiore dhe cilësore. Ky veprim lidhet me synimin e parë (efikasitet dhe cilësi), por synon gjithashtu parandalimin e vonësve të tepërta dhe adresimin e procedurave të gjata, si dhe adresimin e ngarkesës aktuale të çështjeve të prapambetura.

Objektiva të tjerë të parashikuara në këtë qëllim janë përmirësimi i metodave të punës (2.2) dhe gjithashtu përmirësimi i reformave të nevojshme ligjore në të drejtën procedurale, me qëllim nxitjen e reformave të tilla ligjore.

¹⁶ “Matja e cilësisë së drejtësisë”, CEPEJ(2016)12, paragrafi 15, <https://rm.coe.int/1680747548>.

¹⁷ Ibid., parag. 10.

Në lidhje me këtë Objektiv, Këshilli parashikon disa rreziqe që mund të bëhen pengesë serioze për përmbushjen me sukses të tij brenda afateve të parashikuara. *Së pari*, vonesat e pajustificuara në miratimin nga Kuvendi të paketës së ndryshimeve ligjore të propozuara nga KLGJ në maj 2024 kanë sjellë vonesa në përmbushjen e indikatorëve të suksesit të përcaktuara në Strategjinë e Uljes së Numrit të çështjeve të Prapambetura 2024-2027. *Së dyti*, vështirësitë infrastrukturore të gjykatave të apelit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në akomodimin e stafit shtesë. *Së treti*, vonesat në procedurat e promovimit të gjyqtarëve veçanërisht ato të ndërlidhura me aktivitetin e institucioneve të tjera si KPA apo ILD etj.

Synimi 3: “Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve përmes vendosjes/përdorimit të teknologjive më të përparuara”.

Një plan i tërë për përparimin drejt digjitalizimit të Shqipërisë është parashikuar në Agjendën e Reformës. Digjitalizimi i sistemit të drejtësisë duhet të jetë pjesë e tij. Brenda Udhërrëfyesit, objektivi i parë i përcaktuar është zbatimi i sistemit elektronik të integruar të menaxhimit të çështjeve, duke lëvizur drejt digjitalizimit të plotë të procedurave, sipas të udhëzimeve të CEPEJ.¹⁸ Kapacitetet e IT-së duhet të përmirësohen për një akses dhe trajtim të shpejtë të të gjitha bazave të të dhënave. Kjo duhet të koordinohet me institucionet e tjera të qeverisë për të siguruar lidhshmërinë, si dhe pavarësinë dhe konfidencialitetin e sistemit të TI-së të gjykatës. Koordinimi është një nga qëllimet kryesore të Udhërrëfyesit-së, i cili synon të sigurojë që qëllimet e tjera të zbatohen saktë. Koordinimi me projekte të tjera mbi digjitalizimin do të përmirësohet për të qenë në gjendje të përfitojmë nga mjetet digjitale për të ndihmuar në ofrimin e mjedisit të përshtatshëm për të siguruar efikasitetin e sistemit të drejtësisë në planin afatgjatë.

Për programin e digjitalizimit, Udhërrëfyesi përfshin veprime përkatëse në ofrimin e trajnimeve për të gjitha gjykatat, si dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme *hardware* dhe të TI-së. KLGJ-ja do të analizojë nëse ka nevojë për miratimin e një kuadri të ri ligjor për zbatimin e sistemit digjital të çështjeve dhe gjithashtu për mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore në sferën digjitale.

Synimi 4 “Rritja e kapaciteteve gjyqësore/administrative”

Sipas këtij synimi, Udhërrëfyesi parashikon kryesisht zhvillimin e trajnimeve për stafin jo-gjyqtar, në fushat e nevojshme. Zhvillimi i një planifikimi institucional për trajnimin e vazhdueshëm dhe përditësimi i rregullt i kurrikulave, si dhe ngritja e një mekanizmi për të identifikuar rregullisht nevojat për stafin e gjykatës dhe këshilltarët/ndihmësit ligjorë do të kryhet brenda objektivave sipas qëllimit 4. Qëllimi është të përfshihen aktivitetet e

¹⁸ Në këtë drejtim, shih Udhëzimet e CEPEJ “Mbi paraqitjen elektronike të dokumenteve gjyqësore (e-filing) dhe digjitalizimin e gjykatave (CEPEJ (2021)15), të disponueshme në: <https://rm.coe.int/cepej-2021-15-en-e-filing-guidelines-digitalization-courts/1680a4cf87>

trajnimin në një skemë institucionale për t'i ofruar stafit të gjykatës mundësinë dhe motivimin për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre gjatë gjithë karrierës së tyre.

Objektivi nuk është vetëm të kryhen kurse trajnimi, por të rriten kapacitetet e stafit të gjykatës dhe gjithashtu të sigurohet që aktivitete të tilla trajnimi të kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, si në aspektin e përmbajtjes ashtu edhe të metodologjisë.

*Sipas objektivit 4.4 “Rritja e kapaciteteve udhëheqëse/menaxhuese të gjyqtarëve”, parashikohen rregulla mbi zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe ndërtimin e kapaciteteve për aftësitë menaxheriale për ta, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara në Opinionin Nr. 19 (2016) të CCJE-së mbi “Rolin e Kryetarëve të Gjykatave”.*¹⁹

Synimi 5 “Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore për të përmbushur standardet moderne”

Udhërrëfyesi parashikon planin e prioritizimit të ndërtimit/rinovimit, për identifikimin e nevojave më urgjente. Kostot e alokuara për këtë aktivitet janë thelbësore për zbatimin e planit të rinovimit dhe për të bërë një plan realist të prioritizimit të infrastrukturës.

Synimet 6 “Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në aktivitetet e sistemit gjyqësor” dhe 8 “Rritja e besimit publik”, adresimi i qëllimeve gjithëpërfshirëse, të cilat janë të lidhura me të gjitha qëllimet e mëparshme dhe do të kontribuojnë në krijimin e një komunikimi më të mirë midis pushtetit gjyqësor dhe qytetarëve, duke shpjeguar problemet dhe mjetet aktuale, si dhe sfidat me të cilat përballen. Në fund të fundit, vetëm një gjyqësor që punon në mënyrë efikase, të pavarur dhe me integritet do të jetë në gjendje të gëzojë besimin e publikut. Megjithatë, një strategji e përshtatshme komunikimi mund të kontribuojë gjithashtu në kundërbalancimin e sulmeve kundër gjyqësorit, si dhe në rritjen e besimit që është i nevojshëm për legjitimitetin e gjyqësorit. Evolucioni digjital siguron instrumente të përshtatshme për të rritur transparencën e të gjitha institucioneve.

Synimi 7 “Rritja e bashkëpunimit me bashkëpunëtorët kryesorë të gjykatës”.

Objektivat e përcaktuara nën këtë titull synojnë të krijojnë struktura bashkëpunimi të vazhdueshëm (nëpërmjet marrëveshjeve ose takimeve) me institucionet dhe autoritetet kryesore që luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e sistemit të drejtësisë. *Sipas Objektivit 7.3 “Përmirësimi dhe institucionalizimi i bashkëpunimit të KLGJ-së dhe gjykatave me Dhomën e Avokatisë”* parashikohet forcimi i bashkëpunimit me avokatët. Avokatët janë aktorë thelbësorë në administrimin e drejtësisë. Gjyqtarët duhet ta pranojnë rolin e avokatëve dhe, si avokatët ashtu edhe gjyqtarët, duhet ta kuptojnë rolin e njëri-tjetrit në sistemin e drejtësisë, si aktorë të pavarur. Ata duhet të tregojnë respekt për njëri-

¹⁹ Shih Opinionin Nr. 19 (2016) të KKGJE-së mbi “Rolin e Kryetarëve të Gjykatave”, Strasburg, 10 nëntor 2016, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/1680748232>

tjetrin dhe, ndërsa mbajnë pozicione të ndryshme në gjyq, duhet të punojnë për të siguruar që sistemi i drejtësisë të funksionojë në një mënyrë të drejtë dhe efikase.

Mënyra se si janë strukturuar dhe funksionojnë në praktikë bashkëveprimet midis avokatëve dhe gjykatave jo vetëm që do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të palëve, por synojnë gjithashtu parandalimin e abuzimeve dhe gabimeve, duke siguruar mjedisin e duhur për të gjykuar çështjet dhe për të parandaluar vonesat. Por gjyqi është gjithashtu edhe shfaqja publike e drejtësisë në veprim, dhe kështu imazhi i qytetarëve dhe besimi i tyre në sistemin e drejtësisë do të ndikohen fuqimisht nga mënyra se si avokatët dhe gjyqtarët bashkëveprojnë në gjykatë. Mirëkuptimi i ndërsjellë, respekti i ndërsjellë dhe profesionalizmi së bashku me pajtueshmërinë me standardet etike do të kontribuojnë që ndërveprime të tilla të jenë të qeta, gjë që do të ketë një ndikim pozitiv në promovimin e drejtësisë së gjyimit, si dhe në efikasitetin e të gjithë sistemit të drejtësisë. Prandaj, Udhërrëfyesi ndërmerr një veprim proaktiv drejt krijimit të kanaleve të bashkëpunimit, jo vetëm në nivel institucional, por edhe duke identifikuar kryesisht elementët që po dëmtojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e duhur të përbashkët dhe duke organizuar ngjarje/trajnime të përbashkëta.

Synimi 9: Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Udhërrëfyesit

Në fakt, ky synim i fundit nuk është një qëllim i mirëfilltë, por një pasojë e nevojshme për të siguruar zbatimin e Udhërrëfyesit. Ai në thelb parashikon krijimin e një komisioni të përkohshëm për të ndjekur progresin e zbatimit të veprimeve të parashikuara në Udhërrëfyes. Komisioni jo vetëm që do të marrë dhe analizojë të dhënat e dërguara nga departamentet përgjegjëse dhe gjykatat, por gjithashtu do të jetë në gjendje të miratojë masa konkrete për të përshtatur prioritetet në varësi të sfidave që mund të hasen. Përsëri, bashkëpunimi këtu është gjithashtu një koncept kyç.

Udhërrëfyesi është hartuar për një periudhë prej 3 vitesh (2025-2027), e cila është në përputhje me afatin kohor të dokumenteve strategjike mbi reformën e gjyqësorit të përmendur më lart. Udhërrëfyesi parashikon një raportim tremujor mbi zbatimin nga autoritetet dhe institucionet e përfshira për të vlerësuar progresin. Komisioni mund të bjerë dakord të publikojë një vlerësim vjetor të progresit të Udhërrëfyesit.

IV. BASHKËPUNËTORËT DHE BASHKËPUNIMI

Për të konsoliduar efikasitetin e sistemit gjyqësor, mbetet thelbësore të vijohet me forcimin e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve që veprojnë në fushën e drejtësisë. KLGJ-ja riafirmon qasjen e saj institucionale bashkëpunuese dhe proaktive duke përfunduar urat e saj të bashkëpunimit me palët kryesore të interesuara vendase dhe partnerët ndërkombëtarë. Ky bashkëpunim është kritik, pasi efikasiteti gjyqësor nuk është vetëm përgjegjësi e gjyqësorit, por kërkon angazhimin aktiv të një game të gjerë aktorësh, secili duke luajtur një rol jetësor në përmirësimin e sistemit.

- *Gjyqtarët dhe stafi i gjykatave* mbeten partnerët kryesorë të Këshillit në avancimin e reformave që synojnë konsolidimin e pavarësisë dhe performancës së gjyqësorit. Gjyqësori duhet të udhëheqë përpjekjet për të reformuar proceset, për të përqafuar përparimet teknologjike dhe për të siguruar trajtimin e çështjeve me cilësi të lartë. Gjyqtarët dhe stafi i gjykatave duhet të jenë në ballë të zbatimit të ndryshimeve dhe të sigurojnë që reformat të kryhen në mënyrë efektive.

- Në veçanti, *kancelarët e gjykatave*, si administratorë të gjykatave, shpesh përfshihen në mbikëqyrjen e veprimtarive thelbësore të gjykatave dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave gjyqësore - veçanërisht në mbikëqyrjen e integritetit të teknologjisë, sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe sigurimin e një administrate gjyqësore të trajnuar mirë, etikisht dhe profesionalisht të shëndoshë.

- Bashkëpunimi me *pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv* mbetet thelbësor, veçanërisht për miratimin në kohë të ndryshimeve ligjore apo të fondeve financiare që garantojnë efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga integriteti në BE. Këshilli do të vazhdojë të intensifikojë bashkëpunimin e tij me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

- Bashkëpunimi me institucione të tjera të sistemit të drejtësisë si *Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD)*, *Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)*, *Shkolla e Magjistraturës (SHM)*, *Prokuroria (PP)* dhe të tjerë është gjithashtu thelbësor për një qasje të unifikuar e të harmonizuar.

- *Profesionistët e ligjit* (avokatë, ndërmjetës, ekspertë, etj.) luajnë një rol kyç në sigurimin që gjyqësori të funksionojë në mënyrë efektive dhe efikase. Avokatët mund të bashkëpunojnë me gjyqësorin duke iu përmbajtur praktikave efikase gjyqësore, duke përdorur metoda alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe duke mbështetur masa që zvogëlojnë vonesat e panevojshme dhe çështjet e prapambetura.

- *Shoqëria civile dhe publiku* janë gjithashtu partnerë të rëndësishëm në zbatimin e Udhërrëfyesit. Besimi dhe mbështetja e shoqërisë civile dhe publikut janë thelbësore për suksesin e reformave në drejtësi. Ndërtimi i besimit kërkon së pari komunikim të hapur midis gjyqësorit dhe publikut, si dhe sigurimin që reformat të përputhen me nevojat e shoqërisë dhe të kuptohen dhe mbështeten nga të gjithë.

- *Partnerët ndërkombëtarë*, mbeten aleatë të rëndësishëm që mund të kontribuojnë për të ofruar mbështetje të fortë dhe profesionale në zbatimin e reformave të parashikuara, jo vetëm në nivel ligjor, por edhe në ndarjen e praktikave më të mira, kryerjen e programeve të trajnimit dhe ofrimin e vlerësimeve të ekspertëve në mekanizmat e vlerësimit dhe monitorimit.

Përpjekja e përbashkët e të gjitha palëve është jetike për krijimin e një sistemi drejtësie që jo vetëm funksionon në mënyrë efektive, por është gjithashtu i besueshëm, transparent

dhe i aftë të përmbushë nevojat e njerëzve të cilëve u shërben. Vetëm përmes kësaj qasje të unifikuar mund të arrihen reforma kuptimplote dhe të qëndrueshme në drejtësi.

**UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN
E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI
2025-2027**

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.1 Një plan i miratuar në vitin 2025 për hapjen e të gjitha pozicioneve vakante brenda vitit 2026 dhe plotësimi i 80% të të gjitha vakancave në fund të vitit 2027 Rezultati i pritshëm: 1.1.2 Numri i pozicione vakante të shpallura në vit: - Gjatë vitit 2025 shpallen:	Përgatitja e një plani për hapjen progresive të pozicioneve të reja dhe plotësimin progresiv të vakancave të mbetura për gjyqtarë me qëllim përsheptimin e funksionalitetit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP), Gjykatës Administrative të Apelit (GJAA) dhe Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJAKKO) dhe miratimi i tij brenda vitit 2025 sipas procesit: - Shpallja e vendeve vakante të mbetura çdo vit;	Dhjetor 2025 (Miratimi i planit)	Dhjetor 2026 (Hapja e të gjitha vakancave) Dhjetor 2027	Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Zbatimit të

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
- 2 pozicione vakante në GJKKO - 1 pozicion vakant në GJAKKO - 3 pozicione vakante në GJAJP - 3 pozicione vakante në GJAA - Brenda vitit 2026 shpallen të gjitha pozicionet vakante të mbetura në GJAJP dhe GJAA (pas përfundimit të procesit të rivlerësimit qershor 2026) Tregues bazë: - 20 pozicione të shpallura në vitin 2024	- Vlerësimi i kandidatëve në bazë të kualifikimeve dhe performancës, pikëzimi dhe renditja sipas rezultateve; - Ngritja në detyrë e kandidatëve të kualifikuar në pozicionet vakante. Monitorimi i zbatimit: - Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të planit për hapjen e pozicioneve dhe plotësimin e vakancave - Raportim 3 muor: Raportim çdo 3 muaj në mbledhjen plenare të KLGJ nga Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Zbatimit		(Plotësimi i 80% të vakancave në gjykatat e apelit)	Udhërrëfyesit për Efikasitetin Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.3 Deri në fund të vitit 2027 garantohet plotësimi progresiv i vakancave: - 90% të organikës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; - 80% të organikës së gjykatave të apelit; - 90% të organikës së stafit jomagjistrat në të gjitha shkallët e gjykatave) dhe në vitet në	të Udhërrëfyesit për Efikasitetin në bashkëpunim me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës mbi progresin e zbatimit të planit mbi hapjen e pozicioneve vakante, lëvizjeve paralele dhe ngritjes në detyrë.			

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
vijim sigurohet mbajta ose rritja e standardit. Tregues bazë (Qershor 2025) : - 89% e organikës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm e plotësuar - 50% e organikës së gjykatave të apelit të ndara sipas gjykatës specifike: - 42% e organikës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e plotësuar;				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
- 59% e organikës së Gjykatës Administrative të Apelit e plotësuar; - 91% e organikës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e plotësuar; - 72% e organikës së gjykatave administrative të shkallës së parë e plotësuar. - 90% e organikës së stafit jomagjistrat në të gjitha shkallët e gjykatave e plotësuar.				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.4 Ngritja në detyrë e 12 gjyqtarëve në vit Tregues bazë: - 4 gjyqtarë të ngritur në detyrë në vitin 2024 të ndara sipas gjykatës specifike: - 3 ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
- 1 ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit				

Rezultati i pritshëm: 1.1.5.1 Të paktën 50% e reduktimit të kohës së nevojshme për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në 2026 Tregues bazë: 587 ditë për procedurën e ngritjes në detyrë e ndarë sipas gjykatave përkatëse: Gjykata e Lartë - Mesatarja 592 ditë (5 pozicione nga juristë të spikatur) - Mesatarja 519 ditë (16 pozicione nga gjyqtare) Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm - Mesatarja 699 ditë Gjykata Administrative e Apelit - mesatarja 589 ditë Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	Vlerësimi i procesit të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele të gjyqtarëve dhe identifikimi i nevojave për ndryshime të kuadrit ligjor dhe nënligjor	Dhjetor 2025 (vlerësimi)	Qershor 2026 (paraqitja e ndryshimeve ligjore)	KLGJ Komisioni i Zhvillimit të Karrierës Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme
---	---	-------------------------------------	---	--

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
- Mesatarja 452 ditë Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - Mesatarja 673 ditë Tregues bazë: 385 ditë për procedurën e lëvizjeve paralele për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Rezultati i pritshëm: 1.1.5.2 Një raport monitorimi dhe vlerësimi i miratuar				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.6 Një hartëzim i procesit i miratuar	Hartëzimi i procesit të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele për evidentimin e fazave ku nevojitet koordinim, reduktim të kohës dhe rritje të efikasitetit	Korrik 2025 (fillon hartëzimi)	Dhjetor 2025	KLGJ Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.7 Sistemi i gjurmimit funksional	Krijimi i një sistemi gjurmimi (tracking tool) të procesit të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele	Korrik 2025 (fillon zhvillimi i sistemit të gjurmimit)	Dhjetor 2025	KLGJ Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.8 Sistemi i gjurmimit i aksesueshëm <i>online</i>	Vendosja <i>online</i> e sistemit të gjurmimit të procesit të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele me qëllim rritjen e transparencës së këtij procesi	Korrik 2025	Janar 2026	KLGJ Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.9 Të dhënat mbi emërimet, ngritjet në detyrë dhe transferimet në gjyqësor të publikuara në qershor 2025 dhe çdo 3 muaj në vijim	Publikimi i të dhënave të përgjithësuara mbi emërimet, ngritjet në detyrë dhe transferimet në gjyqësor çdo 3 muaj	Korrik 2025	Dhjetor 2027	KLGJ Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.10 Një raport vlerësimi për strukturën e KLGJ dhe nevojat e saj i miratuar	Vlerësimi i strukturës aktuale të KLGJ për të analizuar nevojat për burime njerëzore të mbështetur procesin e ngritjes në detyrë	Korrik 2025	Dhjetor 2025	KLGJ Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.11 Struktura e riorganizuar	Riorganizimi i burimeve të brendshme të Këshillit për të përforcuar mbështetjen për Komisionet e Përhershme për zhvillimin e karrierës dhe veçanërisht vlerësimin etik dhe profesional	Korrik 2025	Dhjetor 2025	KL Gj Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.12 Të paktën 150 gjyqtarë të vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit (të paktën 50 gjyqtarë të vlerësuar në vit) Tregues bazë: - 34 vlerësime të realizuara në vitin 2024.	Kryerja e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve sipas planeve vjetore 2025-2027 Përgatitja e vlerësimit të nevojave për të rishikuar metodologjinë e vlerësimit të performancës në mënyrë që të arrihet një ekuilibër më i madh midis kriterëve cilësore dhe sasiorë dhe transparencës së shtuar të procesit, bazuar në udhëzimet e CEPEJ-it mbi vlerësimin e gjyqtarëve Zbatimi i metodologjisë së rishikuar	Korrik 2025 (Fillimi i përgatitjes së vlerësimit të nevojave)	Dhjetor 2027 (150 gjyqtarë të vlerësuar)	Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.13 Të dhënat e përgjithësuara mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga ILD të publikuara	Publikimi të dhënave të përgjithësuara mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga ILD, duke filluar nga muaji qershor 2025 e vijuar çdo vit brenda 3/6 muajve të vitit pasardhës.	Korrik 2025	Dhjetor 2027	KLGJ Departamenti i Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.14 Plotësimi i strukturës me numrin e plotë sipas organigramës prej 9 punonjësish në fund të 2025. Tregues bazë (qershor 2025): - 4 pozicione të plotësuara	Hapja e thirrjes dhe plotësimi i vendeve vakante me qëllim rritjen e mbështetjes teknike dhe kapaciteteve njerëzore të Njesisë së Vlerësimit të KLGJ-së në mënyrë që ngritjet ne detyrë të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme.	Korrik 2025	Dhjetor 2025	KLGJ Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.15.1 Një raport vlerësimi i hartuar Rezultati i pritshëm: 1.1.15.2 Plotësimi i njësisë me 6 punonjës në fund të 2025. Tregues bazë: - 0 pozicione të plotësuara	Vlerësimi i nevojës për rritjen e mbështetjes teknike dhe kapaciteteve njerëzore të Komisionit të Karrierës në mënyrë që ngritjet në detyrë të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme. Krijimi i njësisë mbështetëse të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës	Dhjetor 2025 (Vlerësimi i nevojës)	Shkurt 2026 (Njësia mbështesë e krijuar)	KL Gj Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.16 Një raport vlerësimi i hartuar	Vlerësimi i mekanizmave ligjore aktuale apo nevojës për ndryshime ligjore për të mundësuar caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve për një vit në pozicione në gjykatat e apelit	Korrik 2025	Dhjetor 2025	KL Gj Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative
Rezultati i pritshëm: 1.1.17 Numri i gjyqtarëve të caktuar përkohësisht	Caktimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatat e apelit për të siguruar funksionalitetin e tyre	Dhjetor 2025 (fillimi i caktimit të përkohshëm)	Dhjetor 2026 (përfundimi i caktimit të përkohshëm)	KL Gj

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.1.18 Një analizë e përgatitur	Hartimi dhe prezantimi i një analize mbi nevojën për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve sipas metodologjisë së CEPEJ	Korrik 2025	Qershor 2026	KLGJ Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

Rezultati i pritshëm: 1.1.19.1 Rreth 103 gjyqtarë të diplomuar deri në vitin 2027 janë caktuar në detyrë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tregues bazë: - 32 gjyqtarë të emëruar dhe të caktuar në detyrë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ në vitin 2024. Rezultati i pritshëm: 1.1.19.2 Deri në fund të vitit 2027 garantohej plotësimi progresiv i vakancave (90% të organikës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrative) Tregues bazë: - 80% e organikës e plotësuar për shkallën e parë juridiksioni i përgjithshëm dhe administrative, 2024	Plotësimi i organikës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrative	Shtator 2025 (42 gjyqtarë të diplomuar të caktuar në detyrë)	Shtator 2026 (40 gjyqtarë të diplomuar të caktuar në detyrë)	Shtator 2027 (21 gjyqtarë të diplomuar të caktuar në detyrë)	KLGJ Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative
---	---	---	--	---	--

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI					
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore				
Objektivi 1.1	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore				
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor			Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027			

Rezultati i pritshëm: 1.1.20.1 Numri i vendeve vakante për lëvizje paralele të shpallura në vit sipas parashikimeve ligjore çdo tre muaj Tregues bazë: - 31 procedura për lëvizje paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të shpallura në vitin 2024. Rezultati i pritshëm: 1.1.20.2 70 % e vendeve vakante për lëvizje paralele të plotësuara në vit Tregues bazë: - 23% e vendeve vakante për lëvizje paralele të plotësuara në vitin 2024	Shpallja e vendeve vakante për lëvizje paralele sipas parashikimeve ligjore; Vlerësimi, pikëzimi, renditja sipas rezultateve të kandidatëve dhe caktimi në detyrë	Korrik 2025	Dhjetor 2027	KLGJ Komisioni i Zhvillimit të Karrierës Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative
---	---	--------------------	---------------------	---

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.2.1 Një plan për krijimin e një sistemi karriere për punësimin e ndihmësve ligjor i miratuar	Përgatitja e një plani gjithëpërfshirës për të vendosur në dispozicion një numër të mjaftueshëm ndihmësish ligjorë dhe këshilltarësh ligjorë për të lehtësuar ngarkesën e çështjeve të prapambetura në gjykata dhe emërimin e tyre të mëvonshëm në shërbimin civil gjyqësor. Analizë dhe propozime për ndryshimin e ligjit për hapjen e vendeve të lira të punës për ndihmës ligjorë sipas standardeve dhe praktikave më të mira të BE-së. Hartimi i një sistemi karriere profesionale për rekrutimin dhe punësimin e ndihmësve ligjorë/ këshilltarëve ligjorë përmes Shkollës së Magjistraturës.	Korrik 2025	Dhjetor 2025	KLGJ Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimin dhe Buxhetit

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.2.2 Një raport vlerësimi me propozime për ndryshime ligjore për të siguruar karrierën profesionale i hartuar.	Vlerësimi dhe hartimi i ndryshimeve të mundshme ligjore të nevojshme për të rritur zhvillimin profesional të këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë brenda sistemit gjyqësor.	Korrik 2025	Dhjetor 2025	
Rezultati i pritshëm: 1.2.3 Takime koordinuese periodike me MD dhe Komisionin e Ligjeve 2025-2026 për të nxitur/lehtësuar miratimin e ndryshimeve ligjore	Avokimi për miratimin e ndryshimeve ligjore në Kuvend të përcjella si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (urdhrrat e ekzekutimit, gjyqtari i vetëm në apel për çështje civile dhe administrative).	Shtator 2025	Dhjetor 2025	KL GJ
Rezultati i pritshëm: 1.2.4 Kuotat e pranimit të miratuara brenda muajit Janar të çdo viti	Miratimi i kuotave të pranimit në Trajnimin Fillestar çdo vit nga Shkolla e Magjistraturës	Janar 2026	Janar 2027	KL GJ

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Tregues bazë: - 10 kuota profili ndihmës ligjor të pranuar në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025 - 3 kuota profili ndihmës ligjor që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2025-2026	Hartimi i zgjidhjeve për të rritur numrin e kandidatëve që ndjekin Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere për të rritur numrin e kandidateve qe ndjekin Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës Përditësimi i organikave dhe i numrit të këshilltarëve ligjorë/ndihmësve ligjorë në njësitë ligjore të gjykatave përkatëse (përfshirë gjykatat e shkallës së parë dhe Gjykatën e Lartë)	Korrik 2025	Dhjetor 2027	Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Tregues bazë: 90 % e numrit të stafit mbështetës i plotësuar sipas strukturave të miratuara në Qershor 2025				
Rezultati i pritshëm: 1.2.5 Rreth 95% e numrit të stafit mbështetës i plotësuar sipas strukturave të miratuara në vitin përkatës Tregues bazë: - 90 % e numrit të stafit mbështetës i plotësuar sipas strukturave të miratuara në Qershor 2025	Ndjekja e vazhdueshme nga ana e KLGJ e plotësimit të nevojave me staf mbështetës nga ana gjykatave	Korrik 2025	Dhjetor 2027	Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet mirëadministratimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.2.6 Raport i paraqitur çdo tre muaj për plotësimin e strukturave të miratuara	Raportim periodik nga ana e gjykatave mbi statusin e plotësimit të strukturave të miratuara, problematikat e hasura dhe rekomandimet			Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative
Rezultati i pritshëm: 1.2.7 Plan buxhetor i miratuar për plotësimin e numrit të punonjësve mbështetës jo gjyqtar sipas standardeve europiane	Raport vlerësimi për rritje graduale të numrit të stafit mbështetës jo gjyqtar sipas standardeve të CEPEJ i shoqëruar nga plani buxhetor përkatës	Dhjetor 2025	Dhjetor 2027	Drejtoria e Programimit & Monitorimit të Buxhetit Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Administrative

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.3	Rritja e efikasitetit nëpërmjet zbatimit të standardeve kohore dhe sasiore të miratuara nga KLGJ			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.3.1 Aktet nënligjore mbi standardet kohore/sasiore të miratuara	Miratimi i akteve nënligjore për përcaktimin e standardeve kohore dhe sasiore	Korrik 2025	Tetor 2025	Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit
Rezultati i pritshëm: 1.3.2 Një raportim çdo vit mbi respektimin e standardeve kohore dhe sasiore të miratuara nga KLGJ	Ndjekja periodike e zbatimit të standardeve kohore dhe sasiore	Tetor 2026	Tetor 2027	Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit

--	--	--	--	--

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
Rezultati i pritshëm: 1.4.1 Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mbi ndërmjetësimin dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	Rritja e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Dhomën Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit	Janar 2026	Qershor 2026	KL GJ, Departamenti i Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë
Rezultati i pritshëm: 1.4.2 Dy tryeza të rrumbullakëta të organizuara mbi ndërmjetësimin dhe	Organizimi i takimeve/tryezave mbi problematikat e zbatimit të mekanizmit, dhe analizimi nevojën për ndryshime ligjore për të intensifikuar përdorimin e tij.	Janar 2026	Shtator 2026	KL GJ, Departamenti i Shërbimeve Juridike dhe

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve				Marrëdhëniet me Jashtë
Rezultati i pritshëm: 1.4.3 Një aktivitet i përbashkët për gjyqtarët dhe avokatët organizuar mbi ndërmjetësimin në konfliktet gjyqësore	Organizimi i një aktiviteti të përbashkët për gjyqtarët dhe avokatët mbi ndërmjetësimin në konflikte të caktuara gjyqësore. Prezantimi i mjeteve dhe udhëzimeve ekzistuese të CEPEJ mbi ndërmjetësimin.	Janar 2026	Shtator 2026	KLJGJ, Departamenti i Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë
Rezultati i pritshëm: 1.4.4 Nr. i fletëpalosjeve të shpërndara	Rritja e ndërgjegjësimit për avantazhet e ndërmjetësimin në bashkëpunim me DHKN	Janar 2026	Dhjetor 2026	KLG

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
				Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun
Rezultati i pritshëm: 1.4.5.1 Katër raportime periodike nga gjykatat në vit si pjesë e raportimeve periodike të gjykatave. - Deri në fund të vitit 2027, krahasuar me vitin 2024, 15% më shumë e çështjeve të referuara nga gjykatat, do të zgjidhen me ndërmjetësim, duke forcuar kështu efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të	Raportimi periodik i gjykatave pranë KLGJ për numrin e çështjeve të referuara për ndërmjetësim	Dhjetor 2025	Dhjetor 2027	KLGJ, Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
ndërmjetësimit në trajtimin e çështjeve gjyqësore. Treguesi bazë: Deri në fund të vitit 2024, numri i çështjeve të referuara për ndërmjetësim nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ishte 3 çështje (Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës) - Deri në fund të vitit 2027, krahasuar me vitin 2024, do të zgjidhen me				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
ndërmjetësim 15% më shumë e çështjeve të filluara me ndërmjetësim. Treguesi bazë: Deri në fund të vitit 2024, numri i çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim të referuara nga gjykatat ishte 0 çështje. Rezultati i pritshëm: 1.4.5.2 Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim të referuara nga gjykatat dhe numrit total të çështjeve				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
Objektivi 1.4	Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e backlogut			
Treguesit e suksesit (Matësit)	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor		Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
		2025 - 2027		
të referuara për ndërmjetësim nga gjykatat (%); Treguesi bazë: jo i aplikueshëm për vitin 2024 duke qenë se nuk rezultojnë raste të zgjidhura me ndërmjetësim nga çështjet e referuara nga gjykatat Rezultati i pritshëm: 1.4.5.3 Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të filluara me ndërmjetësim (%).				

UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI				
Synimi 1	Zgjidhja në kohë të arsyeshme e çështjeve & vendimmarrje cilësore			
